



**Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë**  
**DEPARTAMENTI PËR MONITORIM**

**Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Raport mujor – Qershor 2008**

Ky raport mujor nënvizon shkelje të ligjit vendor dhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe fokusohet në:

(1) Sulmet dhe kërcënimet ndaj gjyqtarëve për shkak të sigurisë së pamjaftueshme në gjykata kanosin pavarësinë e gjyqësorit dhe sundimin e ligjit në Kosovë: dhe

(2) Caktimi i gabuar i vlerës së objektit të çështjes kontestuese, ndikon në të drejtën për gjykatë të themeluar sipas ligjit dhe në të drejtën për ankesë

### **Sulmet dhe kërcënimet ndaj gjyqtarëve**

Misioni i OSBE-së në Kosovë është i brengosur se masat e pamjaftueshme për të ruajtur sigurinë personale të gjyqtarëve në Kosovë mund të kufizojë pavarësinë e tyre dhe të kërcënojnë sundimin e ligjit.<sup>1</sup>

Sipas Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, siguria e gjyqtarëve “do të ofrohet me ligj në mënyrë adekuate”.<sup>2</sup> Veç kësaj, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka vendosur se “duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për t’u ofruar siguri gjyqtarëve siç është të sigurohet prezenca e rojtarëve të sigurisë në objektet e gjykatave ose ofrimi i sigurisë policore për gjyqtarët që mund të jenë ose janë viktima të kërcënimeve serioze.”<sup>3</sup> Rrjedhimisht, autoritetet publike siç janë Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë për detyrë të garantojnë siguri adekuate për gjyqtarë dhe prokurorë.

Megjithatë, kohët e fundit OSBE ka vërejtur sulme dhe kërcënime ndaj gjyqtarëve:

Me 14 prill 2008, dy persona hynë në zyrën e një gjyqtari në një gjykatë në regjionin e Mitrovicës, dhe njëri nga ta e goditi me grusht në fytyrë gjyqtarin. Policia i arrestoi dy individët (babanë dhe të birin e tij). Më vonë, në po të njëjtën ditë, një person i tretë shkoi në shtëpinë e kryetarit të gjykatës komunale dhe e kërcënoi se do ta lëndojë po që se ai nuk i liron dy të dyshuarit (babanë e vëllain e tij).<sup>4</sup>

Me 7 maj 2008, dy persona iu afruan një gjyqtari në objektin e një gjykate në regjionin Pejë/Peć dhe e kërcënuan gojariht se do ta lëndojnë. Me gjasë, i pandehuri e kërcënoi gjyqtarin për shkak se ai kishte refuzuar të ja kthej patentë-shoferin, që ishte konfiskuar, njërit prej sulmuesve.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> OSBE më parë ka raportuar mbi problemin e sigurisë së pamjaftueshme të gjyqtarëve. Shih *Raportin e OSBE-së mbi Administrim e Drejtësisë në Kosovë* (mars 2002) faqe 19 dhe *raportin e OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë*, (dhjetor 2006), faqe 13-14.

<sup>2</sup> Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit (adoptuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryesve (26 gusht deri me 6 shtator 1985), dhe miratuar me rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit), Parimi Nr. 11. Shih gjithashtu Procedurat për Zbatimin Efektiv të Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, Rezoluta 1989/60 e 24 majit 1989, Procedura Nr. 5.

<sup>3</sup> Rekomandimi R (94) 12 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve (adoptuar nga Komiteti i Ministrave me 13 tetor 1994), Parimi III (“Kushtet e duhura të punës”).

<sup>4</sup> Policia arrestoi personin e tretë, i cili gjithashtu po përballet me ndjekje penale.

<sup>5</sup> Pas incidentit, me 23 maj 2008 prokurori publik komunal ngriti propozim akuzë për kërcënim kundër këtyre dy personave (Neni 161(1), Kodi i Përkohshëm Penal).

Me 9 korrik 2007, një gjyqtar në regjionin e Prizrenit lëshoi aktgjykimin me të cilin shtatë të pandehur dënoheshin për plaçkitje. Me 25 shtator 2007, i vëllai i njërit nga të pandehurit vizitoi bashkëshortin e gjyqtares në vendin e tij të punës dhe e kërcënoi se do ta lëndojë atë në qoftë se bashkëshortja e tij (gjyqtarja) nuk i liron të dyshuarit.

Me 27 shkurt 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë/Priština dënoi një të pandehur të profilit të lartë, ish-komandant i UÇK-së, me katër muaj burgim për pengim të personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare<sup>6</sup> dhe kërcënim<sup>7</sup>. Më hollësisht, gjykata gjeti se me 14 nëntor 2005 i pandehuri iu afrua gjyqtarit ekzekutues të Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priština i cili po ekzekutonte dëbimin nga ndërtesa e uzurpuar ilegalisht prej qershorit të vitit 1999. I pandehuri e tërhoqi gjyqtarin ekzekutues për kravatë, duke ia shqyer atë dhe tha: "Do të ngre për tokë dhe do të likuidoj." Përkundër disa vonesave në zbatimin e aktgjykimit, me 8 maj 2008, i pandehuri më në fund filloi të ushtroj dënimin e tij.

Këta shembuj tregojnë se gjyqtarët në Kosovë janë në veçanti cak i kërcënimeve dhe sulmeve. Kjo jo vetëm që ndikon në sigurinë e tyre personale por mund gjithashtu të kufizojë pavarësinë gjyqësore, siç është nxjerrja e një aktgjykimi të paanshëm. Rezultati i një kontesti ligjor duhet të diktohet vetëm përmes zbatimit korrekt të ligjit përballë fakteve dhe jo përmes presionit të jashtëm.

Përderisa sulmet kundër gjyqtarëve në Kosovë janë thellësisht shqetësuese, premtuese është se kanë filluar procedurat penale ndaj kryesve të pandehur. Kjo do të ndihmojë që të tjerët të ngurrojnë të kërcënojnë dhe sulmojnë gjyqtarët në të ardhmen.

Masë tjetër për parandalimin e sulmeve kundër gjyqtarëve është të ofrohet siguri e shtuar në objektet e gjykatave siç janë rojtarët e sigurisë, detektorët e metalit dhe hyrje të veçanta për gjyqtarë dhe personel të gjykatave. Fatkeqësisht, siguria e gjykatave në Kosovë aktualisht është në përgjithësi jo-adekuate.<sup>8</sup> Gjyqtarët të cilët trajtojnë rastet shumë të ndjeshme penale -- siç janë ato që kanë të bëjnë me krim të organizuar, krime lufte ose trafikim me qenie njerëzore -- iu nevojitet mbrojtje e afërt speciale prej 24 orëve.

Rrjedhimisht, pozicioni i OSBE-së është se:

- Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të rrisin sigurinë gjyqësore në objektet e gjykatave dhe zyrat e prokurorive publike siç është instalimi dhe përdorimi i detektorëve të metalit, të krijojnë hyrje të veçanta për gjyqtarë dhe prokurorë dhe t'i pajisin ato me kamera për vëzhgim.
- Në rastet më serioze, policia duhet të ofroj për gjyqtarë dhe prokurorë mbrojtje të afërt speciale prej 24 orëve.
- Individët të cilët sulmojnë apo kërcënojnë gjyqtarët, prokurorët ose personelin gjyqësor duhet të ndiqen penalisht. Gjykatat duhet të marrin parasysh seriozitetin e

<sup>6</sup> Neni 316, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>7</sup> Neni 161, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>8</sup> Për shembull, edhe pse rojtari i sigurisë është kryesisht prezent në hyrje të gjykatave, brenda ndërtesës siguri nuk ofrohet fare siguri apo vetëm e kufizuar. Në qoftë se ka detektor për metal, shpesh ai nuk punon ose nuk bëhet përpjekje që të gjithë vizitorët dhe gjësendet të skanohen në mënyrë të duhur. Shpesh, nuk ka kamera për vëzhgim brenda objekteve të gjykatave.

veprës kur vendosin lidhur me dënimin dhe të ndëshkohen me dënimin maksimal të paraparë me ligj.

### **Caktimi i gabuar i vlerës së objektit të çështjes kontestuese**

Në gusht 2007, OSBE raportoi lidhur me disa procedura civile në të cilat avokatët dhe gjykatat dështuan të përcaktojnë në mënyrë korrekte vlerën e objektit të çështjes kontestuese. Shqetësuese për OSBE-në është se monitorimi i vazhdueshëm ka vënë në pah se problemi akoma vazhdon. Raporti i këtij muaji adreson sërish këtë çështje dhe rithekson problemet që ndërlidhen me dështimin që vlera e kontestit të përcaktohet në mënyrë adekuate.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”) garanton të drejtën e gjykimit korrekt para “gjykatës së pavarur dhe të paanshme të themeluar sipas ligjit.”<sup>9</sup> Në interpretimin e kësaj të drejte, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Gjykata Evropiane”) ka urdhëruar se gjykata duhet të përbëhet në mënyrë të duhur “në përputhje me ligjin” dhe nënvizoi se ka shkelje kur tribunali nuk funksionon në bazë të ligjit të aplikueshëm procedural.<sup>10</sup> Veç kësaj, gjykata Evropiane gjeti se e drejta për gjykim korrekt gjithashtu zbatohet edhe në procedurën ankimore në qoftë se ligji vendor parasheh të drejtën për ankesë.<sup>11</sup>

Sipas Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, përbërja e trupi gjykues dhe e drejta për ankesë pranë Gjykatës Supreme varet nga vlera e kontestit.<sup>12</sup> Ligji lejon ankesa pranë Gjykatës Supreme në kontestet civile vetëm nëse vlera e kontestit e shprehur në pasi tejkalon shumë prej 818.07 EUR. Në qoftë se vlera tejkalon këtë shumë, kolegji përbëhet prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve porotë.<sup>13</sup>

Nenet 35 deri 40 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore përshkruajnë në detaje caktimin e vlerës së objektit të çështjes kontestuese. Në përgjithësi, në qoftë se padia kërkon caktimin e shumës së parave, kjo shume do të jetë relevante në caktimin vlerës së objektit të çështjes kontestuese pa rata të interesit, shpenzimet e gjykatës, dënimet kontraktuale dhe paditë tjera sekondare. Në qoftë se padia nuk kërkon shumë e parave, vlera e objektit të çështjes kontestuese e shprehur nga paditësi në fletë-padi do të merret si relevante. Megjithatë, nëse [p]aditësi ka vlerësuar se vlera e kontestit është dukshëm shumë e lartë apo shumë e ulët, duke shkaktuar kështu pasiguri lidhur me [...] përbërja e gjykatës ose e drejta për rishqyrtim, gjykata në mënyrë adekuate dhe të shpejtë do të vlerësojë saktësinë e vlerës së shprehur më së voni gjatë seancës përgatitore, ose në qoftë

---

<sup>9</sup> Neni 6(1), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>10</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Zand kundër Austrisë*, 7360/76, Raporti i Komisionit, 12 tetor 1978.

<sup>11</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Tolstoy Miloslavski kundër Mbretisë së Bashkuar*, 18139/91, Aktgjykim, 23 qershor 1995, paragrafi 59.

<sup>12</sup> Ligji mbi Procedurën Kontestimore, Nenet. 41-43 dhe 383-383. Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr. 4/77, 36/80, 69/82, 58/84, 74/87, 57/89, 27/90, dhe 35/91.

<sup>13</sup> Rregulli i përgjithshëm është se gjykatat vendosin me kolegji në procedurat civile përpos disa gjykatave që vendosin në seanca të përgjithshme dhe në rastet pronësore ku vlera e kontestit është më e ulët se 818.07 EUR. Nenet 41, 42, 43, Ligji mbi Procedurën Kontestimore; Neni 2(i)(a), Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2001/10, 21 qershor 2001, dhe Neni 3, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut No. 2001/24, 21 dhjetor 2001. *Shih gjithashtu Nenin 8*, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr. 21/78.

se seanca përgatitore nuk është mbajtur, gjatë gjykimit para se të argumentojë lidhur me çështjen parimore.”<sup>14</sup>

Përkundër këtyre dispozitave të qarta, OSBE vazhdon të vëzhgojë procedura civile ku avokatët, palët dhe gjyqtarët dështuan të vlerësojnë në mënyrë korrekte vlerën e objektit të çështjes kontestuese.<sup>15</sup> Rastet në vijim -- në të cilat seancat e para të shqyrtimit kryesor të gjitha janë mbajtur gjatë vitit 2008 -- shërbejnë si shembuj:

Në një rast pranë një gjykate në regjionin Gjilan/Gnjilane, paditësi kërkoi nga gjykata të vërtetojë pronësinë e tij të një banese të blerë në vitin 1999 për 10,000 DM.<sup>16</sup> Në parashtrësën e tij, paditësi përcaktoi vlerën e kontestit në 200 EUR. Gjyqi i përbërë prej një gjyqtari të vetëm mbajti seancën e parë. Duke marrë parasysh çmimin blerës prej 10,000 të banesës, vlera e objektit të çështjes së kontestit duhet të jetë dukshëm më i lartë se 200 Euro, dhe rasti është dashur të shqyrtohej nga trupi gjykues.

Në një rast të parashtruar pranë një gjykate në regjionin Pejë/Peć me 14 shkurt 2008, paditësi kërkoi nga gjykata që të vërtetojë pronësinë e tij lidhur me pronën prej 6.784 metra katrorë. Ai përshkroi vlerën e kontestit në shumë prej 500 EUR, edhe pse prona e asaj madhësie normalisht vlen së paku 30.000 EUR. Shkresat e lëndës zbulojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve porotë, edhe pse rasti duhet të shqyrtohet nga gjyqtari i vetëm në qoftë se faktikisht vlera e kontestit është 500 EUR.

Në një rast pranë një gjykate në regjionin e Prizrenit që lidhej me vërtetimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, paditësi përshkroi vlerën e kontestit në shumë prej 500 Dinarëve ( në kushtet e tanishme, 6.25 Euro). Gjykata vazhdoi procedurën pa e adresuar çështjen e nën-vlerësimit të vlerës së kontestit.

Në rastet e përshkruara më lartë, gjykata dështoi të caktoi në mënyrë korrekte vlerën e objektit të çështjes së kontestit. Kjo jo vetëm që shkel ligjin vendor, por gjithashtu edhe të drejtën për gjykatë të themeluar sipas ligjit siç kërkohet me standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në të tria rastet, dështimi i gjykatës për të kontrolluar saktësinë e vlerës së deklaruar nga paditësi ndikon në të drejtën e paditësit për gjykatë të themeluar sipas ligjit. Në rast se pala vendos të ankohet ndaj vendimit përfundimtar pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, ata mund të mos lejohen ta bëjnë këtë gjë, përpos nëse zgjidhet problemi lidhur me juridiksionin.

Në drejtim të përcaktimit vazhdimisht të gabueshëm të vlerës së kontestit, pozicioni i OSBE-së është se:

---

<sup>14</sup> Neni 40, Ligji mbi Procedurën Kontestimore kërkon nga gjykatat që “menjëherë pas pranimit të padisë” të caktojnë se në çfarë përbërje duhet të gjykohet rasti i veçantë (Neni 15, Ligji mbi Procedurën Kontestimore). Gjatë tërë procedurës, gjykatat duhet të “i japin vëmendje se a bie zgjidhje e kontestit nën juridiksionin e gjykatës” (Neni 16, Ligji mbi Procedurën Kontestimore).

<sup>15</sup> Sipas hulumtimeve të OSBE-së, duket se paditësit mund të nënvlerësojnë vlerën e kontestit në mënyrë që të zbresin shumën e taksave të gjykatës që ata duhet të paguajnë. Sa më e lartë të jetë vlera e kontestit, aq më të larta taksat e gjykatës që duhet paguar.

<sup>16</sup> 10,000 DM janë barazi me 5,112.92 Euro (1 Euro është 1.95583 DM) sipas ratës konvertibile përfundimtare të datës 1 janar 1999.

- Gjyqtarët duhet të kontrollojnë saktësinë e vlerës së objektit të çështjes kontestuese të caktuar nga paditësi në fletë-padi dhe të sigurojnë përbërje adekuate të kolegjit.
- Avokatët duhet që në mënyrë të kujdesshme të marrin parasysh natyrën e padisë kur caktojnë vlerën e objektit të çështjes kontestuese.
- Rekomandohet që Instituti Gjyqësor i Kosovës të ofrojë instruksione shtesë mbi përgjegjësitë e gjyqtarëve për të kontrolluar se a është e saktë vlera e përshkruar e objektit të çështjes kontestuese.
- Rekomandohet që Oda e Avokatëve të Kosovës të ofrojë trajnime për avokatë mbi përgjegjësinë e caktimit të saktë të vlerës së kontestit.